



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 3135

Prishtinë, Dt. 11.09.2024

RAPORT I VLERËSIMIT TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Biologjisë
Projektpropozimi	Ndikimi i metaleve të rënda në disa parametra morfo-fiziologjik dhe tiparet funksionale të gjetheve te misri
Kandidati	Fitore Hoxha
Mentori	Prof. Asoc. Dr. Bekim Gashi
Aprovimi i projekt propozimit në	Datë: 26.01.2023
Këshillin e Fakultetit	Vendimi nr.: 378

Vlerësimi i dorëshkrimit

Punimi i masterit i kandidatës **Fitore Hoxha** është realizuar tërësisht sipas programit të aprovuar nga ana e Këshillit Shkencoro-Mësimor të FSHMN-së, përmban 51 faqe dhe ka këtë përbajtje: Abstrakti (në të dy gjuhët), Hyrje, Shqyrtimi i literaturës, Qëllimi i hulumtimit, Materiali dhe Metodat, Rezultatet, Diskutimi, Konkludimet, Rezume-ja (në të dy gjuhët), Literatura. Punimi është i ilustruar me 2 tabela (në të cilat gjenden rezultatet) dhe 8 figura.

Në **pjesën hyrëse** kandidatja ofron të dhëna të rëndësishme për tokat bujqësore, efektet stresuese e metaleve të rënda në bimë dhe tolerancën e bimëve ndaj stresit të këtyre metaleve. Gjithashtu, në këtë pjesë ka paraqitur të dhëna edhe për gjininë dhe llojin në fjalë (*Zea mays L.*) si dhe për ndikimin e metaleve të rënda në proceset fiziologjike dhe morfolologjike. Kjo pjesë është e strukturuar mjaft mirë dhe ka përbajtje plotësisht në harmoni me temën e hulumtimit dhe rezultatet e pritura.

Qëllimi i studimit është i qartë dhe plotësisht i përbushur me rezultatet e këtij hulumtimi. **Materiali dhe metodat**, janë përshkruar metodat standarde të cilat janë përdorur në këto hulumtime dhe metodat statistike për përpunimin statistikor të rezultateve të fituara që janë kryer me programin SPSS.

Rezultatet – janë paraqitur përmes tabelave. Në dorëshkrimin e punimit janë paraqitur rezultatet për efektin e përqëndrimeve të ndryshme të metaleve, si nikel (Ni), krom (Cr)

dhe plumb (Pb) në disa parametra morfo-fiziologjik te misri. Rezultatet e këtij hulumtimi tregonjë për një efekt tosik të këtyre metaleve sidomos në përqendrime të larta. Për çdo parametër të hulumtuar është bërë përpunimi statistikor i rezultateve, duke u llogaritur mesatarja aritmetike dhe diferenca ndërmjet trajtimeve me metalet e sipërpërmendura dhe gjithashtu janë nxjerr edhe dallimet sinjifikante për $P < 0.05$.

Në kreun **Diskutimi**, kandidatja në mënyrë të detajuar i krahason rezultatet e fituara me rezultatet e autorëve, duke bërë interpretime dhe diskutime në saje të shfrytëzimit të literaturës bashkëkohore adekuate kryesisht të pas vitit 2002.

Në **Konkluzione dhe Rezyme**, në mënyrë koncize është dhënë përbledhja dhe komentimi i rezultateve më të rëndësishme dhe signifikante.

Literatura përmban një numër të konsiderueshëm me referenca, shumica prej tyre publikime të 10 viteve të fundit, me ISSN dhe me Impakt faktor.




Konkluzionet dhe propozimi

Punimi i masterit i kandidatës Fitore Hoxha, për nga forma dhe struktura u përgjigjet standardeve normale. Kandidatja në mënyrë të përpiktë dhe me pedanteri i ka realizuar qëllimet dhe detyrat e hulumtimit. Mënyra e realizimit të punës eksperimentale dhe interpretimit të rezultateve është në përputhje me kriteret shkencore. Komisioni pozitivisht i vlerëson rezultatet, ndërsa dorëshkrinin e punimit të masterit të vlefshëm dhe original, që do të kontribuojë në të arriturat shkencore.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura, me kënaqësi i propozojmë Këshillit Shkencor-Mësimor të FSHMN-së, përkatësisht këshillit Mësimor të Departamentit të Biologjisë që të aprovoj vlerësimin pozitiv të dorëshkrimit dhe të lejoj mbrojtjen publike të punimit të masterit, me titull: "**Ndikimi i metaleve të rënda në disa parametra morfo-fiziologjik dhe tiparet funksionale të gjethive te misri**" titulli Anglisht: "**The effects of heavy metals on some morpho-physiological parameters and leaf functional traits of maize**".

Prishtinë, 05.09.2024

Komisioni:

1. 
Prof. dr. Elez Krasniqi – kryetar
2. 
Prof. asoc. dr. Bekim Gashi – anëtar
(mentor)
3. 
Prof. dr. Sali Aliu – anëtar